



Valmir Berisha, njesoj si dhe Adnand Januzaj po cmendin gjithë Europen. Djaloshi 17-vjeçar që shkëlqeu në Boterorin U-17 me përfaqësuesen e Suedisë, duke shënuar 7 gola në po kaq ndeshje synohet nga Milani. Berisha ka konfirmuar këtë lajm nëpërmjet menaxherit të tij në Suedi por edhe vete ka treguar dicka të tilla. "Klubet që kanë shfaqur me shumë interes për mua janë Ajaks, Milan, Liverpool, Sunderland, Tottenham dhe Celtic. Kam oferta nga Anglia, Italia, Spanja, Gjermania Rusia dhe Holanda. Ekzistojnë shumë opsione, por unë do të shkoj në një klub që ka nevojë për sulmues dhe ku unë të kem mundësi të tregoj të gjithë potencialin tim", ka thënë djaloshti i talentuar që për momentin nuk ka marrë një ftese nga Shqipëria që duket se ka harruar të bëjë atë që detyrohet me talentet që luajnë nëpër bote.